



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.998/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllongjani kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Butrint Golaj nga Gjakova, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021 të datës 03.11.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin e apeluar, për Zgjedhjet Lokale, të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. Pranohet** si i bazuar apeli Anr.998/2021 i datës 03.11.2021, i ushtruar nga Butrint Golaj nga Gjakova, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 2948-2021 të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 0225C/01R, 0212C/05R, 0216C02R, 0211C/01R, 0211C/02D, 0222C/04R, 0223C/01R.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtar të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, Komuna Gjakovës, në Vendvotimet: 0225C/01R, 0212C/05R, 0216C02R, 0211C/01R, 0211C/02D, 0222C/04R, 0223C/01R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.998/2021, të ushtruar nga Butrint Golaj nga Gjakova, Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilin pretendon se në vendvotimet me numër 0225C/01R, 0212C/05R, 0216C02R, 0211C/01R, 0211C/02D, 0222C/04R, 0223C/01R, kanë votuar familjarët e tij, dhe si dëshmi i ka bashkangjitur edhe 9 deklarata të votuesve që deklarojnë se e kanë votuar dhe se në disa prej vendvotimeve nuk figurojnë as votat e tyre të cilët kanë votuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

## Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës Butrint Golaj, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 0225C/01R, 0212C/05R, 0216C02R, 0211C/01R, 0211C/02D, 0222C/04R, 0223C/01R. PZAP, pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga Butrint Golaj Kandidat për Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilin apel kërkon që ti rinumërohen votat në vendvotimet e lartcekur ku kanë votuar familjarët e tij të cilët me anë të deklaratave të tyre kanë deklaruar se e kanë votuar dhe ne cilët vendvotime. Paneli vlerëson se apeli është mbështetur në provat e dorëzuara nga kandidati, ku shihet qarte se në qendrat e votimit 0225C/01R, 0212C/05R, 0216C02R, 0211C/01R, 0211C/02D, 0222C/04R, 0223C/01R, ku kanë votuar familjarët e tij, dhe se ne deklaratat e tyre deklarojnë se kanë votuar kandidatin e tyre te larte cekur dhe se ne disa prej vendvotimeve nuk figuron as një votë, andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura, si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 998/2021 më datën 06.11.2021.

Kryesuesja Panelit  
Afijete Sada Glllogjani



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.